



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:122009

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517417

C.nr.268/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtarin Naim Rekalju, në çështjen juridike të paditëses T.B. nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson me autorizim av.Avni Leci nga Prishtina, kundër të paditurës K.me seli në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim dëmi, më datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses T.B., sipas shenjës C.nr.268/2022, kundër të paditurës K. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim dëmi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditëses T.B. nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Avni Leci nga Prishtina, me datë 15.06.2022, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës K. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

I autorizuari i paditëses av.Avni Leci, me parashtresën e datës 26.02.2024, e kanë njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e ushtruar me datë 15.06.2022, ndaj të paditurës K.

Meqenëse me parashtrësën e datës 26.02.2024, i autorizuari i paditësit i ka propozuar gjykatës që ta konstatoj të tërhequr padinë e tyre, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e konstatuar të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.268/2022, datë 28.03.2024

Gj y q t a r i
Naim Rekalio

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.